

V E N D I M
Nr.102, datë 28.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 26.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.106 Akti që i përket:

- Kërkues:1.Subjekti zgjedhor "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga Ilir Rusmajli.
2.Muslim Murrizi, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga Ilir Rusmajli.
3.Partia Socialdemokrate, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.

Subjekte të Interesuara:

- 1.Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
- 2.Partia Socialiste, përfaqësuar nga Sokol Hazizi.
- 3.Partia Demokrate, përfaqësuar nga Sali Kelmendi.
- 4.Partia Agrare përfaqësuar nga Resmi Osmani.
- 5.Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, në mungesë.

O B J E K T I:

1.Shfuqizimi i vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mosshpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin në zonën zgjedhore nr.60".

2.Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Baza Ligjore: Neni 113 i Kodit Zgjedhor

Për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve kërkuesit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati për deputet Muslim Murrizi kanë parashtruar këto shkaqe:

- Për 19 qendrat e votimit, kutitë e votimit janë dorëzuar në komisionin e zonës zgjedhore të hapura.

- Në qendrat e votimit të komunës Ballagat materialet e votimit janë dorëzuar në orën 15.00 dhe 16.00 të ditës së zgjedhjeve.

- Në qendrën e votimit nr.4 komuna Karbunarë, fshati Zgjanë, si dhe në qendrën e votimit nr.9 komuna Tërbuf, fshati Shenepremte është konstatuar se janë hedhur në kutinë e votimit më shumë fletë votimi se numri i personave që kishin votuar deri në momentin e konstatimit.

Në shumë qendra votimi mungojnë listat, fletët e papërdorura, kundërbiletat dhe vulat.

Nga ana e saj, Partia Socialdemokrate ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kundërshtim me nenin 18/4 të Kodit Zgjedhor, nuk ka shpallur rezultatin përfundimtar për qendrat e tjera, çka nuk na mundëson ankimin në këtë moment. Në këto rrethana, kërkesa jonë është njohja e rezultatit nul në 8 qendra votimi, siç është shpallur nga

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por deklarimi i panevojshëm përsëritja e zgjedhjeve në to si e pabazuar në ligj e në Kushtetutë, për këto arsye: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me të drejtë, ka vlerësuar se shkalla e dhunimit të procesit zgjedhor në zonën nr.60 në tërësi e bën të pavlefshëm rezultatin.

- Ribërja e zgjedhjeve për proporcionalin është në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës, sipas të cilit, për llogaritjen e proporcionalit, njihen vetëm votat e vlefshme të fituara nga partitë e koalicionet në raundin e parë. Pra, Kushtetura lejon vetëm një raund për proporcionalin. Raundi i parë është faza e kualifikimit të partive për të parë se kush kalon pragun e 2.5%. Bërja a ribërja e zgjedhjeve, qoftë edhe pjesërisht, i kthen ato në një lojë politike të barazvlefshme me manipulimin.

- Përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin cenon lirinë dhe barazinë e votës, të sanksionuar në nenin 45/4 të Kushtetutës.

- Barazia e votës cenohet dukshëm edhe për vlerën e efektin që ajo merr gjatë përsëritjeve të zgjedhjeve për proporcionalin. Dhjetra vota në Lushnjë përcaktojnë fatin e 18 deputetëve, pra dhjetra vota marrin vlerën e 180 mijë votave, kur dihet se në proporcional Shqipëria është e gjitha një zonë e vetme elektorale e, si e tillë, vota e gjithkujt duhet të ketë të njëjtën vlerë, pavarësisht nga zona ku votohet, gjë që realizohet vetëm duke patur një raund zgjedhjesh.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pas dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesit e përfaqësuesit e tyre, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendim nr.191, datë 22.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60; të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.1 dhe 6 të Komunës Ballagat; nr.1 dhe 11 të komunës Dushk; nr.1 dhe 6 të komunës karbunarë, si dhe nr.1 dhe 1/1 të komunës Hysgjokaj në zonën zgjedhore nr.60 dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi si për kandidatin e drejtpërdrejtë, dhe për subjektet politike, në datën 29 korrik 2001.

Kundër vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese kërkuesit koalicioni "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati për deputet Muslim Murrizi, të cilët kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim edhe Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, e cila kërkon shfuqizimin pjesërisht të tij. Meqë kërkuesit kanë kundërshtuar të njëjtin vendim të Komisionit të Zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi t'i shqyrtojë këto kërkesa në një gjykim të vetëm.

Kërkuesit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidati Muslim Murrizi, në ankimin e tyre kanë pretenduar se, për disa qendra votimi, kutitë e votimit janë dorëzuar në komisionin e zonës zgjedhore të hapura; në dy qendra votimi materialet e votimit janë dërguar me vonesë; në dy qendra votimi janë gjetur më tepër fletë votimi se numri i votuesve që kishin votuar deri në momentin e konstatimit; në shumë qendra votimi mungojnë fletët e papërdorura, kundërbiletat dhe vulat.

Në kundërshtim me sa pretendohet, në përfundim të gjykit u provua se, me përjashtim të gjashtë qendrave të votimit, për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur përsëritjen e zgjedhjeve në datën 29.7.2001, nuk rezulton që kutitë e votimit të jenë dërguar të hapura në Komisionin Zgjedhor të Zonës nr.60. Është e vërtetë, që siç është konstatuar, ka pasur raste kur

vula është gjetur jashtë ose në ndonjë rast listat e zgjedhësve janë gjetur jashtë kutisë së votimit, por këto parregullsi, në vetvete, nuk mund të përbëjnë shkak për të vënë në dyshim vlefshmërinë e zgjedhjeve në këto qendra votimi.

Edhe pretendimi se në dy qendra votimi janë gjetur në kuti më tepër fletë votimi se numri i zgjedhësve në momentin e verifikimit, nuk u gjet i privuar. Lidhur me këtë pretendim nuk rezulton që komisionerët e koalicionit "Bashkimi për Fitore" në komisionet e qendrave të votimit të kenë shënuar vërejtjet e tyre në procesverbalet apo në tabelat modelare të rezultateve. Vetëm dokumente të tilla, sipas Kodit Zgjedhor, njihen si dokumente zyrtare dhe, si të tilla, kanë fuqi të plotë provuese. Çdo procedurë tjetër dokumentare jashtë atyre që parashikon Kodi Zgjedhor është e dyshimtë e, si e tillë, nuk mund të merret për bazë.

Nga ana e saj, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese anulimin e pjesshëm të vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke urdhëruar që, për 8 qendrat e votimit për të cilat është udhëzuar përsëritja, të mos përsëriten zgjedhjet. Në ankimin e saj Partia Socialdemokrate ka parashtruar se përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin vjen në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës, sipas të cilit, për llogaritjen e proporcionalit njihen vetëm votat e vlefshme të fituara nga partitë a koalicionet në raundin e parë; se Kushtetuta lejon vetëm një raund për proporcionalin dhe se raundi i parë është faza e kualifikimit të partive për të parë se cila kalon pragun e 2.5%; se bërja e zgjedhjeve, qoftë edhe pjesërisht, i kthen ato në një lojë politike të barasvlefshme me manipulimin; se përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin cenon lirinë dhe barazinë e botës, të sanksionuar në nenin 45/4 të Kushtetutës, se barazia e votës cenohet dukshëm edhe për vetë vlerën dhe efektin që ajo merr gjatë përsëritjes së zgjedhjeve për proporcionalin.

Në kundërshtim, sa pretendon pala kërkuese, Gjykata Kushtetuese konkludon se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përsëritjen e zgjedhjeve në 8 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.60, nuk vjen në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Për zgjedhjet e këtij viti për Kuvendin e Shqipërisë, raundi i parë u përcaktua të bëhej më datën 24 qershor, ndërsa për zonën zgjedhore nr.60, meqë raundi i parë nuk u organizua në datën e mësipërme, u caktua të bëhej më datën 8 korrik. Pas zgjedhjeve të organizuara në këtë zonë më datën 8 korrik, meqë u konstatuan shkelje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në 8 qendra votimi më datën 29 korrik. Në këto rrethana, zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.60 në datat 8 dhe 29 korrik, në kuptim të dispozitës së mësipërme të Kushtetutës, përbëjnë raund të parë të zgjedhjeve. Ky raund dallon nga raundi i dytë i zgjedhjeve, që sipas 2/18 të Kodit Zgjedhor, është zhvillimi i një votimi të dytë në një njësi zgjedhore për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar të votave në datën e zgjedhjeve, sipas këtij Kodi. Për pasojë, edhe zgjedhjet e datës 29 korrik në 8 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.60, janë

pjesë e raundit të parë të zgjedhjeve, nga i cili, në vështrim të dispozitës së mësipërme të Kushtetutës, përcaktohet edhe numri i përgjithshëm i deputetëve.

PSD ka pretenduar, gjithashtu, se këto zgjedhje të datës 29 korrik, në këto qendra votimi, nuk duhet të bëhen. Në këtë drejtim arsyetohet se në këtë kohë gati në të gjithë vendin zgjedhjet kanë përfunduar. Jo vetëm kaq, por subjektet zgjedhore kanë ardhur në dijeni të rezultatit si për mazhoritarin, ashtu edhe për proporcionalin, qoftë edhe në mënyrë të përafërt. Në këto kushte, arsyetohet se ndonjë parti që ka marrë në mazhoritar më tepër mandate se sa mund të fitonte në tërësi nga proporcionali, mund të bëjë lojra politike, që në vetvete përbëjnë manipulim të zgjedhjeve, duke shkelur kështu standardin kushtetues të barazisë së votës.

Edhe ky pretendim nuk është i bazuar. Së pari, e drejta e shtetasve për të zgjedhur është një e drejtë kushtetuese, që nuk mund të mohohet. Në rastin në shqyrtim edhe banorët që mbulohen nga 8 qendrat e mësipërme të votimit, të cilët sipas nenit 45/1 të Kushtetutës kanë të drejtë të zgjedhin, përderisa nuk u është krijuar mundësia ta ushtrojnë këtë të drejtë me datën 24 qershor, kjo e drejtë nuk mund t'u mohohet ta ushtrojnë në një datë tjetër. Pretendimi se duke mos u kryer zgjedhjet për proporcionalin më datën 24 qershor, por në një datë tjetër të mëvonshme, ekziston mundësia e

manipulimit të tyre, ka të bëjë me atë se si do të zbatohet Kodi Zgjedhor. Pra, ky mund të jetë një konflikt paszgjedhor, i cili do të zgjidhet sipas procedurave që përcakton Kodi Zgjedhor. Nga ana tjetër, mundësia që zgjedhjet të mos organizohen në përputhje me rregullat që përcakton ky Kod, nuk përbën shkak që ato të mos zhvillohen fare. Një gjë e tillë do të shkelte të drejtën kushtetuese të shtetasve për t'u zgjedhur.

Për sa sipër, të dyja kërkesat duhet të rrëzohen si të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/e dhe 132 të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës të kërkuarve Koalicionit "Bashkimi për Fitore" dhe kandidatit për deputet Muslim Murrizi për shfuqizimin e vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

2. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për shfuqizimin e pjesës së vendimit 191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si të pabazuar.

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM I PAKICËS

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.191, datë 22.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60, si dhe të shpallë të pavlefshme zgjedhjet në 6 qendra votimi, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi si për kandidatin e drejtpërdrejtë, dhe për subjektet politike.

Kundër vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit të Zgjedhjeve kanë bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese, kandidati për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore" Muslim Murrizi dhe subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, që kërkon shfuqizimin pjesërisht të vendimit të sipërpërmendur.

1. Mendoj se kërkuarësi Muslim Murrizi ka paraqitur provat e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljet e bëra në zonën zgjedhore nr.60.

Shumica në vendimin e saj nuk i ka patur parasysh këto prova, si dhe faktin se parregullsitë e konstatuara kanë patur një ndikim përcaktues në rezultatin e zgjedhjeve. Ky ndikim është i lidhur me rëndësinë, diversitetin dhe shumëllojshmërinë e parregullsive të kryera gjatë procesit zgjedhor në zonën zgjedhore nr.60.

Shumica arsyeton se pretendimi që në dy qendra votimi materialet janë dërguar me vonesë, në kundërshtim me nenin 89/2 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit komisionet e qendrave të votimit duhet t'i merrnin materialet e votimit jo më vonë se 12 orë përpara hapjes së votimit, nuk provohet.

Në kundërshtim me sa arsyeton shumica, kërkuarësi ka dorëzuar dy procesverbale të nënshkruara nga anëtarët të KZZ-së dhe të KQV-së, që mbajnë datën 8.7.2001, ku përcaktohen rastet kur materialet e votimit janë dorëzuar me vonesë, në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Konkretisht, bëhet fjalë për qendrën e votimit në Manasufaj, ku materialet janë dorëzuar në orën 15.00 dhe në Zgjanë, komuna Karbunarë.

Gjithashtu, shumica arsyeton se kutitë e votimit nuk rezultojnë të jenë dërguar të hapura nga qendrat e votimit në Komisionin Zgjedhor të Zonës nr.60, megjithëse shumica pranon që janë gjetur vula ose lista të zgjedhësve jashtë kutive.

Ky konkluzion i shumicës mendoj se është i gabuar, sepse në materialet e paraqitura nga kërkuarësi në seancë gjyqësore ndodhet edhe vendimi i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.60, datë

11.7.2001, sipas të cilit kutitë e votimit nga pjesë e qendrave të votimit kanë ardhur të hapura, gjë kjo që vjen në kundërshtim me nenin 107 pika 1/b të Kodit Zgjedhor. Kjo gjë rezulton edhe nga procesverbalet e dorëzimit në Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.60 të kutive të votimit, mbajtur më 8.7.2001 ku nuk janë shënuar kodet përkatëse.

Në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pasqyruar hapja e kutive me kodet përkatëse, duke shënuar se vulat janë të njëjta me ato të procesverbalit të identifikimit të vulave, gjë e cila nuk u provua në seancë gjyqësore.

Në procesverbalin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shumë qendra votimi janë lënë pa numër, megjithëse jepen të gjitha të dhënat për kutitë e votimit (fq.5, 10,19,32, etj të procesverbalit).

Një moment i rëndësishëm, i cili flet për një proces të parregullt, është edhe mbështetja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi tabelat e rezultateve të qendrave të votimit të fotokopjuara, një kopje e të cilave u paraqit para Gjykatës Kushtetuese e panoterizuar, gjë e cila vjen në kundërshtim me nenin 107 të Kodit Zgjedhor.

Në tabelat origjinale të paraqitura nga kërkuarësi, vihen re korrigjime dhe mungesa nënshkrimesh.

Lidhur me pretendimin e kërkuarësit se fletët e votimit të gjetura ishin më tepër se numri i

zgjedhësve që kishin votuar, shumica arrin në konkluzionin se nuk u gjet i provuar.

Mendoj se ky konkluzion është i gabuar, pasi në procesverbalin e mbajtur më 8.7.2001 nga Komisioni i Qendrës së Votimit komuna Karbunarë dhe i nënshkruar si nga komisioni edhe nga vëzhguesit ka rezultuar se kanë qenë hedhur në kuti 36 fletë votimi më tepër se numri i zgjedhësve që kanë votuar në këtë qendër.

Mbi bazën e tij, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.60 ka marrë vendim për të mos hedhur rezultatet e kësaj qendre votimi në tabelën përfundimtare.

Të gjitha këto parregullsi, si dhe parregullsi të tjera më të vogla të pasqyruara në procesverbalin e Komisionit të Zonës Zgjedhor dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në tërësi mendoj se e bëjnë procesin e votimit të pavlefshëm në zonën zgjedhore nr.60.2. Përsa i përket kërkesës së Partisë Socialdemokrate për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.191, datë 22.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke urdhëruar që për 8 qendrat e votimit për të cilat është urdhëruar përsëritja të mos përsëriten zgjedhjet për proporcionalin, mendoj se nuk duhet kërkuar në këtë moment.

Kjo për faktin se rezultati për proporcionalin nuk ka dalë dhe nuk mund të përcaktohet ndikimi që ka kjo zonë në ndarjen e mandateve në proporcional.

Për sa sipër, mendoj se kërkesa duhet të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese mbas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për proporcionalin, duke vendosur pushimin e gjyqimit në këtë Gjykatë.